

## KONTRATË SHIT - BLERJE KUOTE

Sot, më date 03.03.2022 (dymijë e njetetë e dy), u paraqitën Shitësit dhe Blerësi, të cilët ranë dakord për hartimin e kësaj Kontratë me termat e mëposhtme:

**SHITËSI: Artion Plaku**, atësia Luan, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J20521001B, i datëlindjes 21/05/1992, lindur në Ura Vajgurore dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 34% të kapitalit të shoqërisë "THOSE" shpk.


**SHITËSI: Fatjon Bruçi**, atësia Faik, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I71128042U, i datëlindjes 28/11/1987, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 33% të kapitalit të shoqërisë të kapitalit të shoqërisë "THOSE" shpk.

**BLERËSI: Lavdosh Bala**, atësia Haki, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal F40922043O i datëlindjes 22/09/1954, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**OBJEKTI:** Shitja e kuotave të shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, në masën 34% të kapitalit themeltar, nga ortaku "Artion Plaku" dhe në masën 33% të kapitalit themeltar, nga ortaku "Fatjon Bruçi" dhe blerja e tyre nga Z. Lavdosh Bala.

### PARAKUSHTE:

- **Z. Artion Plaku**, është ortak i Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me NUIS M11720002O dhe zotëron në këtë shoqëri një kuote të saj, e cila përfaqëson 34% të masës së kapitalit të kësaj shoqërie.
- **Z. Fatjon Bruçi**, është ortak i Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me NUIS M11720002O dhe zotëron në këtë shoqëri një kuote të saj, e cila përfaqëson 33% të masës së kapitalit të kësaj shoqërie.
- **Z. Lavdosh Bala** është ortak i Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me NUIS M11720002O, dhe zotëron në këtë shoqëri një kuotë të saj, e cila përfaqëson 33 % të masës së kapitalit të kësaj shoqërie.
- **Z. Lavdosh Bala**, ka kërkuar dhe dëshiron të blejë pjesën në masën prej 34% të kapitalit të shoqërisë që Ortaku "Artion Plaku" zotëron në shoqërinë "THOSE" Sh.p.k., dhe "Artion Plaku" dëshiron të shesë pjesën prej 34% të kuotës që ai zotëron në shoqërinë "THOSE" Sh.p.k.





**Z. Lavdosh Bala**, ka kërkuar dhe dëshiron të blejë pjesën në masën prej 33% të kapitalit të shoqërisë që Ortaku "**Fatjon Bruçi**" zotëron në shoqërinë "THOSE" Sh.p.k dhe "**Fatjon Bruçi**" dëshiron të shesë pjesën prej 33% të kuotës që ai zotëron në Shoqërinë "THOSE" Sh.p.k.

• Blerësi **Z. Lavdosh Bala** për të realizuar këtë blerje kuotash është njohur me çdo të dhënë dhe tregues të aktivitetit tregtar të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k., të gjendjes ekonomike, financiare dhe juridike të saj, të drejtave dhe detyrimeve civile, administrative dhe tatimore, aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë, dhe deklaron se i pranon dhe nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me to, dhe se nuk do të ngrëje asnjë pretendim ndaj tyre dhe asnjehere në të ardhmen.

Me vendimin e datës 03.03.2022 të Ortakëve të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k., u vendos shitja në masën 67 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "THOSE" shpk nga ortaku Artion Plaku në masën 34% dhe Fatjon Bruçi në masën 33% si dhe blerja e kësaj mase nga ana e blerësit Z. Lavdosh Bala.

## NENI 1

### OBJEKTI I KONTRATES

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k., në masën prej 67 % të kapitalit themeltar, kuotë e cila zotërohet nga ortaku i shoqërisë "Artion Plaku", në masën 34% në cilësinë e shitësit dhe në masën 33% nga ortaku i shoqërisë "Fatjon Bruçi" në cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre përkatesisht nga Z. Lavdosh Bala në cilësinë e blerësit në këtë kontratë.

Shitja e kuotës së mësipërme, e cila përbën 67% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, sjell humbjen e së drejtës së pronësisë së ortakëve se Z. Artion Plaku në masën prej 34% dhe Fatjon Bruçi në masën 33%, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, dhe blerësi përfiton po në këtë masë.

### KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, struktura e kapitalit të Shoqërisë Tregtare "THOSE Sh.p.k", do të jetë si më poshtë:

1. Z. Lavdosh Bala zotëron 1 (një) kuotë, në masën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k.

Transferimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotën do të jetë njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj kontrate.



## NENI 2

### ÇMIMI I SHITJES DHE PAGESA

Çmimi i këtij transaksioni shit - blerje kuote të Shoqërisë "THOSE" Sh.p.k, do të jetë shuma prej 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, vlera e kuotës së shoqërisë.

Palët deklarojnë se e gjithë vlera e kësaj kontrate është paguar në datën nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palët nuk do të kenë sot apo në të ardhmen asnjë pretendim mbi vlerën e shitjes.

## NENI 3

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET MBI KUOTA

Blerësi është i ndërgjegjshëm për të drejtat dhe detyrimet që ka kuota që ai do të behet titullar i saj. Ai pranon fitimin e pronësisë me të drejtat dhe detyrimet që ka kuota.

## NENI 4

### DISPOZITA TE FUNDIT

Ligji i zbatueshëm është shqiptar. Per cdo gjë që nuk parashikohet ne këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, I ndryshuar.

Kontrata hartohet ne 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me 3 (tre) flete secila (nga 1-3), nga të cilat një e mbajnë palët, nje kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare te Biznesit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

## PALËT

### SHITËSIT:

**Z.Artion Plaku**

**Z.Fatjon Bruçi**

### BLERËSI:

**Z.Lavdosh Bala**

*Përfaqësuar nga Znj.Sibora Jonuzaj,  
në bazë të prokurës Nr.2050 Kol,  
Nr.4216 Rep, datë 21/12/2021*

*Sibora Jonuzaj*